Rev.nr.222/2019

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetarë, Emine Kaçiku dhe Shukri Sylejmani anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N. A. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson R. A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S," me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson Sh, G,, për kompensimin e demit duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4231/14 datës 15.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.10.2019 morri ketë :

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4231/14 datë 15.04.2019.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë,C.nr.1416/08 datës 23.04.2014, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N, A, nga Prishtina me të cilen ka kërkuar të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S," në Prishtinë, që paditësit në emër të demit material për shkak të zvogëlimit të aktiviteti punues për rentë për periudhën nga data 01.01.2013 deri me 31.01.2014, të paguaj shumen prej 1.646,00 € ndërsa për të ardhmen nga data 01.02.2014 e tutje të paguaj për çdo muaj shumën nga 127.00 € deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore. Njëherit u vendos që se cila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4231/14 datë 15.04.2019, nën pikën I të dispozitivit aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit N, A, nga Prishtina dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1416/08 datës

23.04.2014, dhe gjykohet si në vijim: aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N, A, nga Prishtina dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë që të njëjtit si pasoj e aksidentit të pësuar me datën 17.05.2008 në rr. Magjistrale Ferizaj-Prishtinë, konkretisht në fshatin ..., komuna e Ferizajt në emër të demit material për fitimin e humbur për periudhën e kaluar nga data 01.01.2013 e deri me 31 .01.2014 t 'ia paguaj shumen në lartësi prej 1.646,00 € me kamat si kurë se për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar e cila paguhet në Bankat Komerciale të Kosovës duke llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 23.04.2014 e deri në pagesën definitive, kurse duke filluar nga data 01.02.2014 e tutje t' ia paguaj çdo muaj nga 127,00 €, deri sa për ketë të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë apo ky vendim të mos ndryshohet, me kamat sipas arritjeve mujore për pagesë e deri në pagesën definitive të gjitha këto brenda afati prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Nën pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë që paditësit N. A. në emër të shpenzimeve procedurale t ' ia paguaj shumen në lartësi prej 1.061,00 € brenda afati prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material me propozim që revizioni të aprovohet duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe ankesën e paditësit të refuzoj, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Paditësi në përgjigje në revizion thekson se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruar në revizion, propozon që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lendes aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlershmit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lendes del se me datë 17.05.2008 në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë konkretisht në fshatin ..., komuna e Ferizajit kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit si pasoj i të cilit paditësi N. A., (person i tretë) kishte pësuar lëndime të renda trupore më afër të

përshkruar në ekspertizat mjeko ligjore të cilat gjinden në shkresat e lendes dhe për shkak të këtyre lëndimeve ka zvogëlim të aftësi punuese 40 %. Në ketë çështje juridike për aspekte të tjera të demit pasuror dhe jo pasuror me datë 28.06.2012 në seancë të shqyrtimit kryesor është lidhur pajtimi gjyqësor, mirëpo objekt shqyrtimi dhe i vlerësimit i këtij kontesti është fitimi i humbur për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese për 40 % të paditësit që i referohet në realizimin e të hyrave mujore të cilat do ti realizonte sipas rrjedhjes normale të çështjes, por ketë fitim nuk e realizon për shkak të pasojave të shkaktuara nga ky aksident.

Gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për arsye se paditësi nuk ka arritur të provoj demin material të pësuar për shkak të kufizimit të aktiviteti punues në shkallë 40 %. Ekspertiza e ekspertit financiar nuk është e besueshme, pasi që paditësi nuk ka provuar lartësinë e demit që i është shkaktuar si pasoj e kufizimit të aftësisë punuese, kjo sepse paditësi si pas informatave të administratës tatimore ka realizuara të ardhurat mujore në shumë prej 230,00 €. Nga këto arsye e refuzon kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, por gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit. Prandaj për ketë arsye aktgjykimin e gjykatës së shkallë së par e ndryshon dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur me revizion.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar çenderimin juridike të gjykatës së shkallë së dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat e paditura thirret në revizion, e as shkelje tjera thelbësore procedurale në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën material me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë sa i përket lartësisë së pagesës të fitimit të humbur-rentës të paditësit duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Mesë palëve nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë si dhe fakti se paditësi

për shkak të lëndimeve të renda trupore të pësuara në fatkeqësinë e komunikacionit ka zvogëlim të aftësisë punuese 40 % dhe nuk mund të ushtroj veprimtarin e vetë si më parë, të cilën e ka ushtruar gjer më ditën e lëndimit. Këto fakte janë vërtetuar me ekspertizën e eksperteve mjekësor lidhur me lëndimet e paditësit, ndërsa lartësia e fitimit të humbur është vërtetuar me ekspertizën e ekspertit – aktuarit A. G.

Gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale lidhur me lartasin e fitimit të humbur për periudhën prej 01.01.2013 e deri me 31.01.2014 duke pranuar shumen prej 1.646,00€ si dhe në emër të rentës mujore duke llogaritur për punëtor te pa kualifikuar shumën prej 127 € në muaj duke filluar prej datës 01.02.2014 e në të ardhmen deri sa ekzistojnë kushtet ligjore për ketë pagesë, duke pasur parasysh veprimtarin të cilën e ushtron paditësi dhe përqindjen e zvogëlimit të aftësisë punues për ketë veprimtari, duke dhen arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Sipas dispozitës së nenit 189 paragrafi 1 të LMD-së, parashikohet se i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e demit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të humbur. Me paragrafin 3 e të njëjti nenë parashikohet se gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta, ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi. Rrethana se paditësi për periudhën e caktuar ka realizuar të ardhura nuk e kufizojnë atë në kompensimin për terë kohen për sa ka pasoja të zvogëlimit të aftësisë punuese e në formë të humbjes të ardhurave që janë pasoj të zvogëlimit të aftësisë punuese. Lidhur me ketë për humbjen e të ardhurave nuk duhet kuptuar të ardhurat e realizuara nga marrëdhënia e punës, por edhe të ardhurat tjera të cilat paditësi do ti realizonte sipas rrjedhjes normale duke ushtruar veprimtarin e caktuar, po që se të mos kishte pasur zvogëlim të aftësisë punuese. Njëherit i dëmtuari i cili si pasoj e aksidenti të ndodhur ka mbetur me pa aftësi për punë apo me aftësi të zvogëluar ka të drejtë në kompensim të demit për humbjen e të ardhurave pa marrë parasysh se këto të ardhura nuk i ka paraqitur organeve kompetente tatimore. Në rastin konkret gjykata e instancës me të ulët në mënyrë të drejt kanë vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit drejt ka zbatuar të drejtën materiale lidhur me lartësinë e demit respektivisht fitimit të humbur për periudhën e caktuar si dhe për rentën mujore

në bazë të ekspertizës të ekspertit aktuarit A. G. Prandaj në kontekst nga lart të cekurat pretendimet e palës së padituré paraqiten si të pa bazuara.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr 222/2019 datë 07.10.2019

Kryetar i kolegji

Isa Kelmendi